



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**

Numri i lëndës: 2022:108828  
Datë: 24.06.2024  
Numri i dokumentit: 05849354

**K.Dh.Sh.II.nr.470/24**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS** - Dhoma e Shkallës së Dytë, me gjyqtaren Franciska Zhitija Ymeri, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Kompania Regjionale Ujësjetllësi “Prishtina” Sh. A, me NUI: 810547549, me seli në rr. “Hazir Shala”, Nr. 4, në Prishtinë, kundër debitorit Pro Credit Bank Sh.A., me seli në Prishtinë Rr.”Xhorxh Bush” nr.26, duke vendosur lidhur me ankesën e ushtruar të kreditorit, kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.1531/22 të datës 22.11.2023, me datën 24.06.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** e pabazuar ankesa e kreditorit Kompania Rajonale Ujësjetllësi “Prishtina” SH.A., me seli në Rr. ”Hazir Shala”, nr.4 në Prishtinë ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr. 1531/22 të datës 22.11.2023, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr. KPPP.nr. 1531/22 të datës 22.11.2023, e ka

pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit Pro Credit Bank Sh.A., me seli në Prishtinë Rr."Xhorxh Bush" nr.26, ashtu që Urdhri Përmbarimor P.nr. 69/22, i lejuar më datë 29.03.2022, nga Përmbaruesi Privat Fadil I. Hoxha, SHFUQIZOHET.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë kreditori ushtruar, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovoj këtë ankesë dhe ta refuzoj prapësimin e debitorit.

Debitori nuk ka ushtruar përgjigje në ankesë

Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore (LPP), gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori, ka paraqitur propozim për përmbarim ndaj debitorit, P.nr. 69/22 të datës 29.03.202, me të cilin ka lejuar përmbarimin, në bazë të dokumentit të besueshëm: në bazë të ekstraktit të verifikuar nga librat afarist të kontabilitetit me shifër L57514, duke e obliguar debitorin që në afat prej 8 ditësh nga dita e pranimit të këtij urdhri t'i paguaj kreditorit borxhin prej 900.78 €, si dhe shpenzimet e përmbarimit, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm, me ndalimin e mjeteve në para të cilat i ka debitori në xhirollogarinë e tij bankare, dhe bartjen e shumës përkatëse në xhirollogarinë bankare të kreditorit, ose me konfiskimin dhe shitjen publike të sendeve të luajtshme të debitorit dhe bartjen e atyre mjeteve në xhirollogarinë e kreditorit. Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, e ka kundërshtuar prapësimin si të pa bazuar, ndër të tjerash ka theksuar se konsideron se borxhi i kërkuar nga ekstrakti i nxjerrë një anshëm nga kreditori është më i vjetër se periudha një vjeçare andaj kërkesa e kreditorit është e parashkruar. Tutje ka shtuar se urdhri përmbarimor është lëshuar me shkelje të dispozitave ligjore, përkatësisht duke konstatuar dhe vërtetuar gabimisht gjendjen faktike dhe pa u

mbështetur në prova. I ka propozuar gjykatës ta aprovoj prapësimin e debitorit dhe urdhri përmbarimor të shfuqizohet.

Kreditori brenda afatit ligjor nuk ka paraqitur përgjigje në prapësim.

Gjykata e shkallës së parë pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, si dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore (tutje LPP) dhe nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 Për Procedurën Përmbarimore, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbarimor duhet të anulohet dhe procedura përmbarimore të përfundohet në tërësi, me arsyetim se në rastin konkret dokumenti i besueshëm - Ekstrakti i verifikuar nga librat afarist Nr. Nr.L57514, në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbarim, nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se “Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”, ndërsa në par.2 të po këtij neni, si dokument i besueshëm sipas ligjit konsiderohen “ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave”, ndërsa me nenin 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se “Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar“, kurse me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se “Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”

Në rastin konkret pavarësisht faktit se propozimi për përmbarim është lejuar sipas Ekstraktit nga librat e kontabilitetit, bashkëngjitur sipas shifrës L57514, rezulton se borxhi në shumën prej 900.78 €, është kërkuar për periudhën kohore nga data 01.01.2013 deri me datën 28.03.2022, ndërsa në përmbajtjen e këtij ekstrakti, nuk është përfshirë fare periudha prej datës 01.01.2013 deri me datën 31.12.2013, me ç’rast nuk dihet se për cilat shërbime dhe për cilën periudhë kohore është grumbulluar borxhi në fjalë.

Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë

çështje e pranon edhe Gjykata Komerciale Dhoma e Shkallës së Dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i ankimuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se Gjykata e Shkallës së Parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbartimore kur e ka aprovuar propozimin e debitorit, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës shihet qartë se propozimi për përmbartim është lejuar sipas, Ekstraktit nga librat e kontabiliteti –Kartela Financiare e Konsumatorit, në kuadër të KRU “Prishtina” Sh.A., gjykata gjen se dokumenti mbi të cilën mbështet propozimi për përmbartim nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, sepse nuk i përmban tiparet e një ekstrakti nga librat afarist, për shkak se në këtë dokument nuk janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturës si dhe periudha kohore për të cilën kërkohet përmbushja e detyrimit. Po ashtu nga ekstrakti afarist i bashkëngjitur sipas shifrës L57514, rezulton se borxhi në shumën prej 900.78 €, është kërkuar për periudhën kohore nga data 01.01.2013 deri me datën 28.03.2022, ndërsa në përmbajtjen e këtij ekstrakti, nuk është përfshirë fare periudha prej datës 01.01.2013 deri me datën 31.12.2013, me ç’rast nuk dihet se për cilat shërbime dhe për cilën periudhë kohore është grumbulluar borxhi në fjalë.

Kjo gjykatë vlerësoj pretendimet ankimore se kreditori kërkon borxhin nga data 31.07.2020 deri me datën 31.03.2022 por e refuzoi si të pa bazuar për shkak se kreditori këtë periudhë e cek vetëm me ankesë ndërsa në propozim për përmbartim nuk është cek fare periudha kohore gjegjësisht nga cila datë e kërkon borxhin dhe deri në cilën datë, po ashtu edhe në ekstraktin afarist sipas shifrës L57514 nuk është e qartë periudha kohore.

Andaj gjykata e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim në pajtim me dispozitat ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe gjykata e shkallës së dytë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve kësaj gjykatë i rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë i bazuar. Më të drejt gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se kreditori në rastin konkret nuk ka ofruar prova juridikisht të vlefshme në mbështetje të pretendimeve të tij.

Përndryshe në procedurën përbarimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përbarimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e Shkallës së Dytë

K.Dh.Sh.II nr.470/24, me datë 24.06.2024

Gjyqtarja,  
Franciska Zhitija Ymeri

Numri i lëndës: 2022:108828  
Datë: 24.06.2024  
Numri i dokumentit: 05849354